

VENDIM
Nr.19, datë 6.1.1997

PËR FUNKSIONIMIN E KURSEVE TË KUALIFIKIMIT DHE TË SPECIALIZIMIT PRANË SHKOLLAVE TË LARTA

Në zbatim të ligjit nr.810, datë 6.4.1996 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 39 dhe me propozimin e Ministrisë së Arsimit të Lartë dhe Kërkimeve Shkencore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pranë shkollave të larta, kur plotësohen kushtet, hapen kurset e kualifikimeve afatshkurtra e afatgjata, si dhe kurset e specializimeve për specialistët me arsim të lartë.

2. Kurset e kualifikimit dhe të specializimit janë kurse studimi në shkollën e lartë, nëpërmjet të cilave bëhet e mundur përfitimi, thellimi dhe përditësimi i vazhdueshëm i njohurive të nivelit universitar nga specialistë me arsim të lartë.

3. Hapja e kurseve të kualifikimit dhe të specializimit bëhet nga Ministria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimeve Shkencore, mbi bazën e projekteve të propozuara nga shkollat e larta. Projekti duhet të paraqesë:

- objektivat e kursit;
- dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm mbi stafin akademik, infrastrukturën dhe skemën e financimit;
- modalitetet e organizimit, të cilat të garantojnë liritë bazë akademike.

Projekti duhet të jetë i pajtueshëm me ligjin e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë dhe vendimet e Këshillit të Ministrave për arsimin e lartë.

Vendimi për hapjen e kursit duhet të përcaktojë:

- tipin e kursit, kualifikimin ose specializimin;
- fakultetin/universitetin përgjegjës;
- kohëzgjatjen (në ngarkesë mësimore);
- emërtimin e certifikatës;
- modalitetet e organizimit;
- skemën e financimit dhe efektet financiare.

4. Mbyllja e kurseve të kualifikimit dhe të specializimit bëhet nga Ministria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimeve Shkencore:

- kur veprimtaria e kursit bie ndesh me ligjin e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë dhe vendimet e Këshillit të Ministrave për arsimin e lartë;
- kur kërkohet nga shkolla e lartë.

Vendimi për mbylljen e kursit duhet të parashikojë mundësi që të gjithë kursantët të përfundojnë kursin e filluar.

5. Kurset e kualifikimit dhe të specializimit nuk duhet të cenojnë veprimtarinë kryesore të shkollës së lartë.

6. Pranimet në kurset e kualifikimit dhe të specializimit bëhen me konkurs. Modalitetet e organizimit të kurseve të pranimit dhe të vlerësimit të rezultateve përcaktohen në rregulloret e kurseve. Kuotat e pranimit në këto kurse propozohen nga shkolla e lartë dhe miratohen nga Ministria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimeve Shkencore.

7. Në varësi të kohës së studimeve, kurset e kualifikimit janë afatshkurtra ose afatgjata. Kurset afatshkurtra duhet të përmbajnë jo më pak se 40 leksione. Kurset afatgjata duhet të përmbajnë jo më pak se 120 leksione.

8. Kurset funksionojnë mbi bazën e planeve mësimore. Dokumentacioni i tyre është i njëjtë me atë të veprimtarisë kryesore të shkollës së lartë. Planet mësimore hartohen dhe administrohen nga grupi i lektorëve dhe miratohen nga dekani i fakultetit.

9. Në përfundim të kurseve të kualifikimit dhe të specializimit lëshohet certifikatë nga fakulteti, pranë të cilit kryhen me sukses studimet. Certifikata shpreh tipin e kursit, kohëzgjatjen dhe

vlerësimin cilësor të zotëruesit të saj. Modeli dhe forma e certifikatës që jepet nga këto kurse, miratohen nga Ministria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimeve Shkencore.

10. Kurset e kualifikimeve dhe të specializimeve u nënshtrohen tarifave të shkollimit, të cilat caktohen nga Ministria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimeve Shkencore. Tarifat e shkollimit administrohen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.478, datë 7.11.1992 dhe udhëzimeve përkatëse të nxjerra në zbatim të tij.

Shteti nuk merr përsipër koston e jetesës (ushqim dhe fjetje) së pjesëmarrësve.

11. Modelitetet e organizimit dhe funksionimit akademik, administrativ e financiar të kurseve të kualifikimit dhe të specializimit përcaktohen nga Ministria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimeve Shkencore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi